

**VENDIM**  
**Nr. 237, datë 27.7.2023**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K.”  
SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA  
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1931/1 prot., datë 26.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘G.S.K.’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1931 prot., datë 17.7.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “G.S.K.” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a” dhe “c”; dhe për pikën 2.1, gerrat: “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9. Format i dokumentacionit për aplikim

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “b”: Të depozitohet në ERE dokumentacioni për disponimin e pjesës së mbetur të vlerës së investimit dhe mënyrën e financimit të kësaj shume.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1: Të bëhet plotësimi përkatës për kapacitetin e secilës njësi gjeneruese (panel) dhe të saktësohet jetëgjatësia e pritshme e centralit.

- Duke qenë se shoqëria ka parashikuar të ndërtojë veprën brenda vitit 2023 dhe në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, vlerësohet t’i kërkohej shoqërisë informacion nëse ka filluar me punimet e saj.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K.” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “G.S.K.” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**